



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1.4, nenin 46 paragrafi 2.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, si dhe mbështetur në Rekomandimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik dhe Agrokulturë 01.98/2017 të datës 20.06.2017, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 29.06.2017 merr:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E STRATEGJISË PËR GRATË NDËRMARRËSE NË
KOMUNËN E GJILANIT PËR PERIUDHËN 2017-2021

1. Me këtë vendim aprohet Strategjia për Gratë Ndërmarrëse në Komunën e Gjilanit për Periudhën 2017 – 2021.
2. Strategjia për Gratë Ndërmarrëse është produkt i projektit “Fuqizimi Socio-Ekonomik i Gruas, Avancim i Shoqërisë Kosovare” në kuadër të programit “Skemat e Garantëve për OJQ-të me baze në komunitet”, i financuar nga Zyra Bashkimit European , mbikëqyrur nga Fondacioni për Shoqëri Civile – KCSF dhe implementuar nga Kosovo Center for Bussiness Support – KCBS.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Strategjia për Gratë Ndërmarrëse në Komunën e Gjilanit për Periudhën 2017 – 2021,e përgatitur nga Kosovo Center for Bussiness Support – KCBS
4. Zbatimin e Strategjisë për Gratë Ndërmarrëse në Komunën e Gjilanit për Periudhën 2017 – 2021 e bënë Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, përderisa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesja e KK-Gjilan.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr. 16-64728
Gjilan, më 29.06.2017

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi